



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:078239

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05595749

C.N.40/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, si gjykatë civile e shkallës së dytë, me gjykatësin individual Ardian Ajvazi, në çështjen juridike të paditësve Z..... G....., Z..... S..... dhe R..... S....., të gjithë nga Prizreni, tani me vendbanim të përkohshëm në Beograd Republika e Serbisë, të cilët me autorizim i përfaqëson av. G..... M..... nga Shtërpca, përmes projektit të ndihmës juridike personave refugjatë, kundër të paditurve G..... S....., të cilin me autorizim e përfaqëson avokati A..... T.....; L... S....., nga fshati d Komuna e Prizrenit, S..... V..... nga fshati M..... Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson av. E.....G..... nga Prizreni dhe M..... P..... nga fshati V..... Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson P..... P..... nga P....., me adresë banimi Rr. ".." p.n, me objekt të padisë anulimin kontratave mbi shitëblerjen e patundshmërisë, vlera e kontestit 216,000 €, duke vendosur lidhur me Propozimin për Përsëritjen e Procedurës të paraqitur nga i padituri G..... S..... përmes të autorizuarit të tij me datën 26.11.2018, jashtë seancës me datën 18.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET SI I PABAZUAR Propozimi i të paditurit G..... S..... nga fshati Dobrushtë, Komuna e Prizrenit, për Përsëritjen e Procedurës në kontestin e përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren/Departamenti i Përgjithshëm C.nr.907/11, të datës 30.11.2015.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin C.nr.907/11, të datës 30.11.2015 ka vendosur si në vijim: APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z..... G....., Z..... S..... dhe R..... S....., të nga Prizreni, si e bazuar. a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e parc. kat. nr. 6615/1 ZK Prizren, Leg.nr.4696/06, datë 25.08.2006, e lidhur në mes të L.....T..... nga fshati Gërncarë, Komuna e Prizrenit dhe të paditurit të parë G.....S..... nga fshati Dobrushtë, Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren. b). DETYROHET i padituri G..... S..... që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë-parc. kat. nr.6615/ 1, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njefti do të shërbejë

si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi. II. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z..... G....., Z..... S..... dhe R.....S....., të nga Prizreni, si e bazuar. a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblelien e parc. kat. nr. 6615/1 ZK Prizren, Leg.nr.4901/06, datë 05.09.2006, e lidhur në mes të I..... T..... nga fshati Gërçarë, Komuna e Prizrenit dhe të paditurit S..... V..... nga fshati M....., Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren. b). DETYROHET i padituri S..... V..... që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë parc. kat. nr.6615/ 1, nga personat dhe sendet, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm. c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin të paditësve. Në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi. III. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve m..... G....., Z..... S..... dhe R..... S....., të gjithë nga Prizreni, si e bazuar. a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e parc. kat. nr. 6615/1 ZK Prizren, Leg.nr.5445/06, datë 03.10.2006, e lidhur në mes të I.....T..... nga fshati Gërçarë, Komuna e Prizrenit dhe të paditurit M..... P..... nga fshati Vërmicë, Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren. b). DETYROHET i padituri M..... P..... që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë parc. kat. nr.6615/ 1, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi. IV. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve Z..... G....., Z..... S..... dhe R..... S....., të gjithë nga Prizreni, si e bazuar. a). VËRTETOHET se është nule kontrata mbi shitëblerjen e patundshmërisë —shtëpisë në vendin e quajtur "Metohia", në sipërfaqe prej 2,88 ari, oborr 5,00 ari dhe arës 17 m2, e regjistruar në listën poseduese nr.76 ZK Prizre, Leg.nr.5566/06, datë 09.10.2006, e lidhur në mes të I..... T..... nga fshati Gërçarë, Komuna e Prizrenit dhe të paditurit Luli Saramati nga fshati Dobrushtë, Komuna e Prizrenit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren. b). DETYROHET i padituri L..... S..... që në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, ta lirojë paluajtshmërinë parc. kat. nr.2627, nga personat dhe sendet, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. c). Pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i njëjti do të shërbejë si bazë për shlyerjen e emrit të të paditurit dhe regjistrimin e emrit të paditësve në regjistrin kadastral, si bashkëpronat të ngastrës së cekur në pikën b) të dispozitivit të këtij aktgjykimi. OBLIGOHEN të paditurit G.....; S....., L... S....., S..... V..... M..... P....., që në mënyrë solidare paditësve Z..... G....., Z..... S..... dhe R..... S....., t'ia kompensojnë shpenzimet e procedurës në shumë e përgjithshme prej 1.913.00 € , në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Aktvendimi C.nr.907/11, datë 08.11.2012, me të cilin është caktuar masa e sigurimit në këtë çështje kontestimore, mbetet në fuqi deri në plotëfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Ky Aktgjykim ka marrë formën e prerë nga data 30.11.2016, kur ankesa e të paditurit e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, me numër dhe datë si më lart, është refuzuar si e pa bazuar nga Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, me Aktgjykimin Ac.nr.1021/2016 të datës 30.11.2016, përkatësisht duke vërtetuar Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

I padituri me datë 26.11.2018 parashtron propozim për përsëritje të procedurës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimoe nga neni 232 pika g).

Paditësit nuk kanë ka parashtruar përgjigje në propozimin e të paditurit.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të këtij propozimi dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me çështjen konkrete juridike, ka gjetur se nuk ekziston asnjë shkak i paraparë me nenin 232 të LPK-së, për lejimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, me të cilin kundërshtohet aktgjykimi i formës së prerë.

Nga referati i Propozimit/Kërkesës së paditësit, shihet se përveç se e konsideron jo ligjor dhe të padrejtë Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren, pretendimi i propozimit për përsëritje të procedurës është se gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore nuk ka mundur të paraqes provën e re, përkatësisht të propozoj që të thirret si dëshmitar I..... T....., për ta sqaruar çështjen se si ka arritur ai deri tek autorizimet dhe kush ia ka dhënë autorizimin atij. Fakti se pala e paditur nuk ka mundur ta propozoj si dëshmitar është se i njëjti gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore ka qenë në arrati. I padituri Gani Saramati para një javë ka kuptuar se I..... T..... është zënë nga Policia e Kosovës dhe është në vuajtje të dënimit në burgun e dubravës.

Në bazë të shkresave të lëndës, i padituri përmes të autorizuarit të tij në seancën e datës 20.02.2015, ka propozuar që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohej I.....T....., të cilin propozim në të njëjtën seancë i është aprovuar nga gjykata e shkallës së parë. Adresën e këtij dëshmitari i padituri nuk e ka dhënë të sakt në seancën e datës 20.02.2015, mirëpo përmes të autorizuarit të tij ka theksuar se të nejtin e ka parë në Shadërvan në Prizren. Gjykata përmes kërkesës së datës 23.02.2015, iu është drejtuar Policisë së Kosovës për sigurimin e adresës së këtij dëshmitari, ndërsa këta të fundit përmes përgjigjes së datës 18.03.2015, kanë theksuar se ky dëshmitar gjindet në Beograd, pa specifikuar adresën e sakt. Pra nga këto rretahan vërtetohen faktet se gjykata e shkallës së parë të paditurit i ka dhënë mundësinë e propozimit për dëgjimin e dëshmitarit të lartë cekur dhe ka bërë tentim për gjetjen e adresës së tij, mirëpo nuk ka pasur sukses, ndërsa sipas dispozitës së nenit 340 të LPK-ës, pala propzuese ka detyrim ta tregoj adresën e dëshmitarit të propozuar, *“Pala e cila propozon që personi i caktuar të pyetet si dëshmitar duhet më parë të tregojë se për çfarë duhet të dëshmoj ai, si dhe ta tregojë emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e tij”*.

Me nenin 232 të LPK-së janë paraparë shtatë shkaqet për të cilat mund të përsëritet procedura e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës kompetente. Gjykata e Apelit, gjatë vlerësimit të bazueshmërisë së propozimit/kërkesës së propozuesit për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e shkallës së parë, ka gjetur se nuk ekziston asnjëri nga shkaqet e parapara me nenin 232 të LPK-së, për lejimin përsëritjes së procedurës në këtë çështje juridike, e cila është shqyrtuar sipas padisë së paditësve, kundër të paditurve, për shkak të anulimit të kontratës.

Sipas dispozitës së nenit 232 pika (g) e LPK-së, gjykata mund ta lejojë përsëritjen e procedurës sipas propozimit të palës: “Në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t’i përdor ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme”. Në bazë të këtyre dispozitave të cituara dhe në bazë të rrethanave të prezantuara në propozimin për përsëritje të procedurës, Gjykata e Apelit vlerëson se rrethanat dhe faktet e paraqitura me propozimin për përsëritje të procedurës nuk përbëjnë shkak që të lejohet përsëritja e procedurës. Kjo për faktin se dispozita e sipërcituar kërkon fakte dhe prova të reja të cilat i parashtron pala, e për të cilat nuk ka ditur deri në marrjen e aktgjykimit të formës së prerë, e të cilat në atë kohë në fakt kanë ekzistuar. Provat e propozuar sipas propozimit për përsëritjen e procedurës nuk është provë e re, për të njejtën i padituri ka pasur njohuri edhe gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, pranë gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera të paditësit në propozim për përsëritje, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në kuptim të dispozitës së nenit 15.1 dhe nenit 235 lidhur me nenin 239.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË**

C.N.40/2021, datë 18.04.2024

Gjyqtari  
Ardian Ajvazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë (kolegjit prej 3 gjyqëtarëve) e përmes po kësaj gjykate, në kuptim të nenit 240.4 të LPK-së.